



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Në vijim të procesit të Integritimit Evropian, pas hapjes së negociatave me Shqipërinë vijon procesi i përgatitjes nga Autoriteti i Konkurrencës si lider i Kapitullit të 8 “Politika e Konkurrencës”, për takimin bilateral Screening i cili do të zhvillohet në muajin Mars 2023 në Bruksel.

Në këtë kuadër, në datën 24 Janar, në ambientet e Hotel Rogner u zhvillua një takim me qëllim simulimin e aktivitetit që do të zhvillohet përpara Komisionit Evropian. Fokusi kryesor i këtij takimi ishte parapërgatitja për një përfaqësim sa më të mirë të Autoritetit të Konkurrencës në Takimin Bilateral Screening.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba vlerësoi suportin e ekspertëve të huaj dhe vendas të projektit SANECA dhe theksoi se Autoriteti i Konkurrencës si lider dhe koordinator i Kapitullit të 8 “Politika e Konkurrencës” do të vazhdojë rolin e tij si një institucion i pavarur për të siguruar konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në funksion të procesit të antarësimit dhe përafrimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor me *aquis* të Bashkimit Evropian.

Takimi vijoj me prezantimet e anëtarëve të Autoritetit të Konkurrencës.

Përfaqësuesit e projektit SANECA, Znj. Blerina Raca, menaxhere e projektit dhe eksperti i këtij projekti, Z. Andrej Plahutnik, ndihmuan me asistencën dhe suportin e tyre në ndjekjen e prezantimeve si dhe me këshillat përkatëse në lidhje me përmirësimin e tyre për një përfaqësim sa më dinjitoz në takimin e rradhës në Mars 2023 me Komisionin Evropian në Bruksel.